

Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIME

A.nr. 71/ 2015

RRUSTEM BEQIRI

lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore në vendosjen e lëndës C.nr. 82/ 2013, në
Gjykatën Themelore në Mitrovicë

Për: Z. Ali Kutllovci, u.d. kryetar
Gjykata Themelore në Mitrovicë

Baza ligjore: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135, paragrafi 3
Ligji për Avokatin e Popullit, neni 16 paragrafi 8

Prishtinë, më 25 tetor 2017

Qëllimi i raportit

1. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes Gjykatës Themelore në Mitrovicë, lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen efikase të lëndëve gjyqësore në afate të arsyeshme kohore.
2. Ky raport është i bazuar në ankesën individuale të z. Rrustem Beqiri dhe mbështetet në faktet dhe provat e ankuesit, si dhe nga shkresat e lëndës të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore për të vendosur në lëndën C.nr. 82/ 2013, në çështjen juridike të marrëdhënies së punës, për kompensimin e të ardhurave personale.
3. Rasti i ankuesit ka filluar të procedohet në gjykata prej datës 3 mars 2003 dhe deri më sot. Pra, ankuesi për 14 vite është në pritje të vendimit, lënda e të cilit ende nuk është vendosur përfundimisht me vendim merititor. Gjykata e shkallës së dytë e ka kthyer në rigjykim vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

I. Përmbledhja e fakteve

Faktet që janë konstatuar deri më tani mund të përmbliidhen si më poshtë:

4. Më 3 mars 2003, ankuesi parashtrroi padi në Gjykatën Komunale në Mitrovicë, lidhur me kompensimin e të ardhurave personale nga marrëdhënia e punës.
5. Më 30 shtator 2004, Gjykata Komunale në Mitrovicë, lidhur me çështjen e ankuesit ka nxjerrë aktgjykimin C.nr. 40/ 2003, me të cilin aprovohet kërkesëpadija e paditësit Rrustem Beqiri, për kompensimin e të ardhurave personale për periudhën prej 1 shtator 1999 deri më 2 tetor 2002, prej 37 muaj, nga 85 euro, gjithsej 3. 145, 00 euro, me kamatë vjetore prej 3.5 %, duke filluar nga data 3 mars 2003, e gjerë në pagesën definitive, si dhe është obliguar e paditura K.T.U. Kosovatrans në Mitrovicë, t'ia kompensoi paditësit shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 202.80 euro.
6. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Mitrovicë C.nr. 40/ 2003 të datës 30 shtator 2004, e paditura K.T.U. Kosovatrans në Mitrovicë ushtron ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, e cila vendos sipas ankesës së të paditurës dhe nxjerrë aktvendimin AC.nr. 311/ 2005, duke e aprovuar ankesën dhe duke e kthyer çështjen në rigjykim në vitin 2013, që evidentohet në librin e regjistrave gjyqësor për vitin 2013, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe lënda evidentohet në numrin C.nr. 82/ 2013.
7. Më 19 gusht 2014, paditësi i drejtohet Gjykatës Themelore në Mitrovicë, me parashtrësën për shpejtimin e procedurës për lëndën C.nr.82/ 2013.
8. Më 19 gusht 2014, Gjykata Themelore në Mitrovicë i përgjigjet paditësit, për lëndën C.nr. 82/ 2013, se kjo lëndë është kthyer në rigjykim dhe i është caktuar gjyqtarit më 16 prill 2013, duke i cekur kushtet e vështira në të cilën punon gjykata, ku 4 gjyqtarë punojnë në një zyrë, pasi të plotësohen kushtet, lënda do të merret në shqyrtim.

II. Hetimet e rastit nga Avokati i Popullit

9. Më 16 shkurt 2015, Institucioni i Avokatit të Popullit ka hapur rastin A.nr. 71/2015, në bazë të deklaratave të paraqitura të ankuesit Rustem Beqiri dhe dokumentacionit si fakte të dorëzuara lidhur me rastin.
10. Më 23 shkurt 2015, Avokati i Popullit i dërgoi një letër Gjykatës Themelore në Mitrovicë, në të cilën kërkoi informata për veprimet e ndërmarra ose ato që planifikonte të ndërmernte, që rasti i ankuesit të shqyrtohej brenda afatit të arsyeshëm bazuar në ligj.
11. Më 9 mars 2015, Avokati i Popullit mori përgjigje nga kryetarja e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, ku u njoftua se, gjyqtari nuk e ka caktuar lëndën, për arsye të kushteve të jashtëzakonshme, pasi që disa gjyqtarë punojnë në një zyrë.
12. Më 24 prill 2015, ankuesi e ka njoftuar IAP-në, se seanca gjyqësore është caktuar.
13. Më 22 maj, 1 qershor dhe 30 shtator 2015, ankuesi ka njoftuar se procedura gjyqësore është në vazhdim, mirëpo ende nuk ka përfunduar.
14. Më 14 mars, 22 gusht 2016 dhe 24 shkurt 2017, përsëri ankuesi ka njoftuar se procedura gjyqësore në Gjykatën Themelore në Mitrovicë nuk ka përfunduar.

III. Instrumentet relevante

15. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 31, paragrafi 1 përcakton *“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike, ndërsa paragrafi 2 përcakton “Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

Ndërsa, neni 32, i Kushtetutës përcakton: *“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”.*
16. Neni 54, i Kushtetutës përcakton se: *“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.*
17. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), në nenin 6 paragrafi 1, garanton se: *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njeri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm.”*
18. Ndërsa, neni 13 i KEDNJ përcakton që: *“Çdo njeri, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me këtë Konventë, ka të drejtë për mjetet ligjore efektive për rivendosjen e së drejtës nga një autoritet kombëtar, pavarësisht se shkelja mund të jetë bërë nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.*

19. Po ashtu, sipas Ligjit për Gjykatat nr.03/L-199, neni 7 paragrafi 5, përcakton që: *“Të gjitha gjykatat duhet të funksionojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruar zgjidhjen e shpejtë të lëndëve.”*
20. Edhe Ligji për Procedurën Kontestimore (LPK) nr.03/L-006, në nenin 10 paragrafi 1, parasheh se *“Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji.”*
21. Neni 12 i këtij ligji obligon gjykatën që *“Procedura e shkallës së parë, si rregull, përbëhet prej dy seancave: a) seancës përgatitore; b) seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes.”*
22. Neni 420, paragrafi 2 i LPK përcakton mënyrën e konvokimit të seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes: *“Seanca kryesore do të mbahet, si rregull, më së voni brenda afatit tridhjetë (30) ditë nga dita në të cilën është mbyllur seanca përgatitore”*. Edhe në paragrafin 4, të njëjtit nen parashihet se: *“Po që se gjykata çmon se shqyrtimi kryesor do të zgjatë më tepër se një ditë, seanca do të konvokohet për aq ditë me radhë sa është e domosdoshme që shqyrtimi të bëhet në vazhdimësi”*
23. Ndërsa, neni 441 paragrafi 1 i LPK, shprehimisht përcakton se: *“Seanca për shqyrtimin kryesor të çështjes nuk mund të shtyhet për kohë të pa caktuar”*. Në paragrafin 2 të po të njëjtit nen përcakton po ashtu se: *“Seanca kryesore dëgjimore nuk mund të shtyhet më shumë se tridhjetë (30) ditë, [...]”*.
24. Neni 475 i LPK përcakton: *“Në kontestet nga marrëdhënia e punës e sidomos me rastin e caktimit të afateve dhe konvokimit të seancave gjyqësore, **gjykata gjithmonë do ta ketë parasysht nevojën e zgjidhjes së ngutshme të kontesteve nga marrëdhënia e punës.**”*

IV. Analiza ligjore

25. Ankuesi është ankuar për dështimin e gjyqësorit, për një proces të rregullt, të drejtë, brenda afatit të arsyeshëm ligjor dhe të drejtën për mjete efektive juridike, të paraparë me nenin 31, nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6 paragrafi 1 dhe nenin 13 i KEDNJ, si dhe nenin 10 paragrafi 1 i LPK. Është shkelur e drejta e ankuesit, ku procedurat gjyqësore kanë zgjatur me shumë se 14 vite, në shkallë të parë dhe në shkallë të dytë, ku përsëri lënda është kthyer në rigjykim në shkallë të parë si ceket më lartë, që ende deri sot nuk është vendosur kjo lëndë.
26. Avokati i Popullit përkujton se gjykata ka për detyrë që procedura gjyqësore të zbatohet, pa ndonjë zvarritje të paarsyeshme. Nga informatat në dispozicion, ankuesi me veprimet/mosveprimet e tij, nuk i ka kontribuar zvarritjes së procedurës, ndërsa zvarritjet pa një vendim përfundimtar i kanë kontribuar shkeljeve të drejtave për mbrojtje gjyqësore, në dëm të ankuesit, të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
27. Avokati i Popullit vëren se asnjë mënyrë apo rrugë e veçantë ligjore nuk ka ekzistuar dhe nuk i është vënë në dispozicion ankuesit, përmes së cilës ai do të kishte mundur të ankohet për zvarritje të procedurës, që do të arrinte, çfarëdo lehtësimi në formë të

parandalimit të padrejtësisë apo kompensimit për padrejtësinë e përjetuar. Kjo mënyrë e veprimit të gjyqësorit dëshmon për mohimin e drejtësisë dhe ligjshmërisë për mbrojtje gjyqësore të drejtave.

28. Po ashtu, Avokati i Popullit përkujton se neni 6 (1) i KEDNJ-së nuk parasheh ndonjë afat absolut për përcaktimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës por, ai përcaktim varet nga rrethanat e veçanta të rastit, veçanërisht nga ndërlikueshmëria e rastit, sjellja e palëve dhe autoriteteve të përfshira, si dhe prej asaj se çfarë është në interes për ankuesin.
29. Duke u bazuar në analizën ligjore, Avokati i Popullit përkujton nenin 13 të KEDNJ-së, që paraqet në mënyrë të veçantë dhe shprehimisht obligimin e shtetit që, në radhë të parë të mbrojë të drejtat e njeriut përmes sistemit të tij ligjor, ofron garanci shtesë për një individ që ai apo ajo gëzon këto të drejta në mënyrë efektive. Kërkesat e nenit 13 përkrahin dhe përforcojnë ato të nenit 6 të KEDNJ. Pra, neni 13 garanton një mjet efektiv ankimi pranë një autoriteti vendor, për një shkelje të pohuar të kërkesave, sipas kuptimit të nenit 6, për ta shqyrtuar një rast brenda një kohe të arsyeshme, sikurse që z. Beqiri ishte ankuar për kohëzgjatjen e procedurës.
30. Avokati i Popullit përkujton se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), ka vërtetuar që në rastet ku përfshihet përcaktimi i të drejtës civile, zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurës gjyqësore (shih aktgjykimin *Girolomi kundër Italisë* të datës 19 shkurt 1991 dhe aktgjykimin *Boddaert kundër Belgjikës*, të datës 12 tetor 1995). Për rastin në fjalë, procedura gjyqësore e ankuesit Rrustem Beqiri, ka filluar me rastin e paraqitjes së padisë në Gjykatën Komunale në Mitrovicë, më 3 mars 2003 dhe rasti ende nuk është përfunduar.
31. Duke u bazuar në nenin 7 të Ligjit për Gjykatat, çdo kush ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës për të kërkuar mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të tij. Në këtë rast, ankuesi mbrojtjen e ka kërkuar prej datës 3 mars 2003, por për arsye të zvarritjes së procedurës për 14 vite, nuk ka një vendim final gjyqësor, që kjo do të thotë nuk kanë mund të zbatohen të drejtat dhe detyrimet e palëve ndërgjyqësore.
32. Neni 12 i këtij ligji obligon gjykatën që "*Procedura e shkallës së parë, si rregull, përbëhet prej dy seancave: a) seancës përgatitore; b) seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes.*" Në seancën përgatitore do të punohet ashtu që çështjet të përgatiten që në seancën kryesore gjykimi mund të përfundoj në mënyrë efikase me një vendim meritore dhe të mënjanohet mundësia e ndërprerjes së procesit dhe të mënjanohen paqartësitë. Në seancën e shqyrtimit kryesor, edhe në këtë fazë, gjykata sigurohet nëse ekziston ndonjë pengesë për zhvillimin e procesit gjyqësor civil. Gjatë seancës për shqyrtimin kryesor, gjykata respekton aspektet formale të procesit, që do të thotë se gjyqtari duhet të siguroj se procesi i materialit të paraqitet në një mënyrë të rregullt, në mënyrë që të shmanget humbja e panevojshme e kohës. Në këtë rast ankuesi na njofton se procedura gjyqësore nuk ka përfunduar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, e cila procedurë po zvarritet.
33. Neni 420, paragrafi 2 i LPK përcakton mënyrën e konvokimit të seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes: "*Seanca kryesore do të mbahet, si rregull, më së voni brenda afatit tridhjetë (30) ditë nga dita në të cilën është mbyllur seanca përgatitore*". Edhe në

paragrafin 4, të njëjtit nen parashihet se: *“Po që se gjykata çmon se shqyrtimi kryesor do të zgjatë më tepër se një ditë, seanca do të konvokohet për aq ditë me radhë sa është e domosdoshme që shqyrtimi të bëhet në vazhdimësi”* Për këtë zgjidhje konsiderohet, se afati prej 30 ditësh, do të jetë i mjaftueshëm si për gjykatën, po ashtu edhe për palët që të përgatitën për seancën kryesore, gjë që edhe nga pikëpamja e praktikës gjyqësore konsiderohet si zgjidhje e drejtë.

34. Ndërsa, neni 441 paragrafi 1 i LPK, shprehimisht përcakton se: *“Seanca për shqyrtimin kryesor të çështjes nuk mund të shtyhet për kohë të pacaktuar”*. Në paragrafin 2 të po të njëjtit nen përcakton po ashtu se: *“Seanca kryesore dëgjimore nuk mund të shtyhet më shumë se tridhjetë (30) ditë, [...]”* Shtyrja e seancave gjyqësore për kohë të pacaktuar, ndikon dukshëm në ndaljen dhe zvarritjen e procedurës pa arsye të justifikueshme dhe për periudha kohore mjaft të gjata.
35. Në kontestet nga marrëdhënia e punës duke u bazuar në nenin 475 të LPK, ligdhënësi ka paraparë se gjykata duhet t'i ndërmarrë të gjitha masat që këto konteste të zgjidhen urgjentisht. Masat të cilat duhet t'i ndërmer gjykata për zgjidhjen me urgjencë të këtyre kontesteve, konsistojnë në marrjen e lëndëve të kësaj natyre me prioritet, para lëndëve të tjera, në caktimin e afateve sa më të shkurtra për mbajtjen e seancave gjyqësore, që palëve ndërgjyqëse t'u caktoj afate më të shkurtra për ndërmarrjen e veprimeve procedurale, por pa e cenuar mundësinë e ndërmarrjes së tyre dhe që të kujdeset që kontesti të përfundojë sa më parë. Gjithashtu, gjykata duhet të kujdeset që distanca kohore midis seancave të jetë sa më e shkurtër dhe që palët në afat sa më të shkurtër ta paraqesin tërë materialin shqyrtues të çështjes me të cilin pretendojnë që t'i realizojnë apo mbrojnë të drejtat apo interesat e tyre subjektive. Në këtë rast gjykata nuk është kujdesur që rasti të përfundojë sa më parë.
36. Avokati i Popullit po ashtu vëren se Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), se më 16 prill 2007, kishte miratuar Planin strategjik për gjyqësorin për periudhën kohore 2007-2012, për t'i zgjidhur lëndët e vjetra, për t'iu siguruar zgjidhje me kohë për të gjitha lëndët, që u ishin dorëzuar gjykatave. Plani i dytë strategjik për periudhën kohore 2014-2019, ishte miratuar për reduktimin e lëndëve. Mirëpo, ankuesi asnjëherë nuk ka përfituar nga planet strategjike, përkundër që lënda e tij ka qenë me prioritet, bazuar në nenin 475 të LPK, që kontestet nga marrëdhënia e punës, kanë prioritet në zgjidhjen e tyre nga gjykata.

V. Konstatimet e Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit konstaton:

Zvarritjet e procedurës gjyqësore shkaktojnë pasoja serioze në sundimin e ligjit dhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Zvarritja për më shumë se 14 vite e rastit të ankuesit nga ana e gjykatave ende pa vendim përfundimtar shkelë:

Të drejtën për gjykim të drejtë, proces të rregullt, brenda një afati të arsyeshëm kohor të përcaktuar dhe të mbrojtur me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6 të KEDNJ.

Të drejtën për mjete efektive juridike të mbrojtura me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 13 të KEDNJ.

Të drejtën për mbrojtje gjyqësore të drejtave të përcaktuara në nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Të drejtën për zgjidhjen e ngutshme të kontesteve nga marrëdhënia e punës të përcaktuara në nenin 475 i LPK.

Duke u bazuar nga të cekurat më lartë, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, “[...] ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore”, dhe nenin 16, paragrafi 8 të Ligjit për Avokatin e Popullit, sipas të cilit “Avokati i Popullit mund të jap rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësorë. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe procedurat tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurës”, bazuar në analizën ligjore të mësipërme, në cilësinë e rekomanduesit, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, me qëllim të përmirësimit të punës në sistemin gjyqësor të Kosovës:


REKOMANDON

Gjykatën Themelore në Mitrovicë

- 1. Të shqyrtoj mundësinë e ndërmarrjes së veprimeve lidhur me vendosjen e rastit C.nr. 82/2013, meqenëse kjo lëndë daton që nga 3 marsi 2003.***

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,



Hilmi Jashari
Avokat i Popullit